



A.nr.440/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.440/2026, të datës 17.04.2026, të parashtruar nga ankuesi F.O, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.440/2026, e datës 17.04.2026, e parashtruar nga ankuesi F.O, ashtu që **shfuqizohet** Vendimi numër 14-112/01-0040664/26 i datës 19.03.2026 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për rishqyrtimin e rastit të ankuesit,.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

F.O (*tutje referuar* ankuesi), me datë 17.04.2026, ka parashtruar ankesë të protokolluar me numër 1983/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-112/01-0040664/26, të datës 19.03.2026, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, përmes të cilit akt ankuesi duke filluar nga data 01.04.2026 kthehet në shërbimin civil, i sistemuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika të Trashëgimisë Kulturore, në Sektorin e Turizmit në Kuadër të Drejtorisë së Turizmit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar* Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 12.05.2026, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1983/2026, të datës 17.04.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vendimin me Nr.14-112/01-0040664/26, të datës 19.03.2026; Kërkesën e datës 23.02.2026 të ankuesit për kthimin në punë pas përfundimit të pezulit të marrëdhënies së punës; Vendimin me numër 14-117/01-65013/21 të datës 13.04.2021; Vërtetimin me numër ref: 4/4-17 të datës 18.02.2026; Vendimin me numër Ref:01B/11 të datës 07.04.2021; Akt emërimit Form-MAP/AE/01 të datës 26.07.2012; Akt emërimit Form-MAP/AE/01 të datës 18.04.2013; Akt emërimit 01.nr.112-997 të datës 01.02.2017; Vendi me numër 01.nr.119-107366 të datës 21.05.2015 lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës shëf i sektorit për arsim; Vendimin me numër 01nr.119-280202 të datës 10.12.2015 lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës shëf i sektorit për arsim; Vendimin me numër 01B/19 të datës 16.04.2021 për emërimin e kryetarit KEPTSH; Vendimin me numër 01B/35 të datës 18.05.2021; Marrëveshjen për shërbime të veçantë të datës 25.04.2017; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 29.03.2018; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 30.06.2020; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.04.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 12.05.2026; Emaillet e datës 15.06.2026, 17.06.2026, 18.06.2026.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje te organi i njëjtë, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt emërimit 01 nr. 112-997 të datës 01.02.2017, është emëruar në pozitën Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Vlerësim, në sektorin e Arsimit në Komunës së Prishtinës.

Si rrjedhojë, ankuesi me datë 12.04.2021 ka parashtruar kërkesë te Kryetari i Komunës së Prishtinës për pezullimin e marrëdhënies së punës në shërbim civil, pasi që i njëjti sipas vendimit të datës të datës 30.03.2021 të Ministres së Arsimit Shkencës , Teknologjisë dhe Inovacionit është emëruar këshilltar politik për arsim para universitar. Kryetari i Komunës së Prishtinës përmes vendimit me numër 14-117/01-65012/21 të datës 13.04.2021 ka lejuar pezullimin e ankuesit i cili në piken III të vendimit ka theksuar qartë se i njëjti pas mbarimit të afatit të pezullimit ka të drejtën e rikthimit në pozitën e mëparshme të punës ose të transferohet në një pozitë tjetër se njëjtës kategori.

Tutje, ankuesi përmes kërkesës së datës 23.02.2026, ka kërkuar kthimin në vendin e punës në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Standarde dhe Vlerësim në Drejtorinë Komunale të Arsimit, si dhe që nga ajo datë të realizoj përfshirjen në sistemin e pagave në përputhje me procedurat administrative dhe aktet nënligjore në fuqi, ndërsa, Kryetarit të Komunës së Prishtinës, përmes Vendimit me Nr.14-112/01-0040664/26, të datës 19.03.2026, ka kthyer ankuesin në shërbim civil në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Politika të Trashëgimisë në Sektorin e Turizmit në kuadër të Drejtorisë së Turizmit, duke filluar nga data 01.04.2026.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se vendimi i kontestuar për ri sistemim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të legjislacionit në fuqi, shkelje të aktit administrativ ekzistues, diskriminim sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i njëjti pretendon se më shumë se katërmëdhjetë (14) vite veprimtaria profesionale e tij është zhvilluar në fushën e arsimit, dhe ri sistemimi në një drejtori tjetër është jo vetëm i pajustificuar nga aspekti profesional e ligjor por gjithashtu i pa përshtatshëm dhe

potencialisht i dëmshëm në ushtrimin efektiv të detyrave, po ashtu ankuesi pretendon se pozita paraprahe e ankuesit është e lirë pasi që nuk ekziston asnjë vendim që e dëshmon të kundërtën.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publik, përkatësisht:

-Neni 37, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.*

-Neni 68, i cili përcakton se: *1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil. 2. Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me kërkesën e nëpunëses/it të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht me këtë ligj. 3. Nëpunëses/it civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga puna dhe marrëdhënia e punës gjatë periudhës së pezullimit, përveç të drejtës për tu kthyer në vendin e punës, sipas këtij ligji.*

-Neni 71, paragrafit 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas këtij ligji, nëpunësja/i civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësja/i civil transferohet në një pozitë tjetër të nivelit profesional. Ndërsa, për nëpunësen/ine nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nëpunësja/i kthehet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar.; si dhe neni 11 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, ku përcaktohet se: 1. Pas përfundimit të pezullimit, përveç kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas LZP-së, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësi civil transferohet në një pozitë tjetër ekuivalente.*

Rrjedhimisht, referuar dispozitave të lartë theksuara ligjore dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit i mbështetur në neni 71 par.1 të theksuar si më lartë, është i bazuar, ngase organi i punësimit në këtë rast Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, nuk kanë dhënë asnjë sqarim, që lidhet me faktin se pozita të cilën ankuesi ka mbajtur para pezullimit të marrëdhënies së punës është e lirë pavarësisht që me datë 15.06.2026 këshilli përmes emailit ka kërkuar sqarim nga organi i punësimit se pozita e ankuesit të cilën e ka mbajtur para pezullimit të marrëdhënies së punës a është e lirë dhe të njëjtën të na dëshmojnë. Tutje me datë 15.06.2026 zyrtarja e Njëjës së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës nuk është përgjigjur në pyetjen vetëm se ka sqaruar se pas kthimit në shërbim civil ankuesi është sistemuar në pozitë ekuivalente dhe që i përgjigjet kualifikimit të tij, po ashtu nuk përbënë ndryshim të koeficientit. Këshilli përsëri përmes emailit të datës 17.06.2026 dhe 18.06.2026 ka bërë përpjekje që të siguroj provat nga organi i punësimit nëse pozita Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Vlerësim në Drejtorin komunale të Arsimit, a është e lirë pasi që edhe në ankesën e parashutuar në këshilli ankuesi pretendon se kjo pozite është e lirë, ndërsa me date 08.07.2026 zyrtarja e Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës përmes emailit ka konfirmuar se pozita të cilën ankuesi e ka mbajtur para pezullimit është e lirë.

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në gjendjen faktike si më lartë theksuar, konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit, lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Vlerësim në Drejtorin e Arsimit në Komunën e Prishtinës, i cili e ka mbajtur sipas aktit të emërimit të datës 01.02.2017 është i bazuar në ligj dhe me anë të gjendjes faktike të pasqyruar si më lartë, rezulton se Kryetari i Komunës së Prishtinës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me 14-112/01-0040664/26 i datës 19.03.2026, nuk ka vepruar në pajtim me nenin 71 paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 11 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, për arsye se me rastin e kthimit të ankuesit në shërbim civil nuk e ka kthyer në pozitën të cilën ankuesit ka qenë, pasi që pozita ka qenë e lirë.

Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Kryetari i Komunës së Prishtinës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj kërkesën e ankuesit lidhur me sistemimin e tij në pozitën të cilën ankuesi ka qenë i punësuar sipas aktit të emërimit dhe nëse kjo pozitë nuk është e lirë të sistemohet në pajtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë, si dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari e Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.440/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.O;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Menaxherit të Personelit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.